

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE

Emri i operatorit: FAMIS CO-HC SH.A. Samadrexhe p.n. - Suharekë
Aktiviteti: Thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror
Vendi: Samadrexhe p.n. - Komuna Suharekë 23000



Samadrexhe, Suharekë

Gusht 2026

PARATHËNJE

Ky aplikacion për Leje Mjedisore për kompaninë *FAMIS CO-HC SH.A. Samadrexhe p.n.* - *Komuna Suharekë 23000* është plotësuar duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes si dhe U.A Nr.03/2011 për Formën, Përmbajtje dhe Mënyrën e plotësimit të Aplikacionit për Leje Mjedisore.

Sipas këtij udhëzimi Administrativ 03/2011, janë plotësuar Formulari 1, nga shtojca 1 si dhe tabelat nga shtojca 2 e këtij U.A . Janë paraqitur si shtojca të gjitha informatat e nevojshme për kompaninë lëndët e para dhe ato ndihmëse, uji, energjia, mbeturinat, monitorimi i emisioneve në ajër, ujë, tokë, TMM, që janë të ndërlidhura me numrat sipas renditjes nga formulari 1 (Shtojca i) e këtij U.A.

DEKLARATE

Përmes kësaj deklarate bëjmë kërkesë për Leje Mjedisore në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe udhëzimit administrativ për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për leje mjedisore.

Garantoj se të dhënat e prezantuara në këtë formularë janë të sakta dhe të prezantuar në mënyrë reale.

Nuk kemi asnjë vërejtje në rregulloret e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe autoriteteve lokale në raste të përdorimit të kërkesës sonë nga palët e interesuara me rastin e shqyrtimit të kërkesës së FAMIS CO-HC SH.A. Samadrexhe p.n. - Komuna Suharekë 23000.

FAMIS CO-HC SH.A. Samadrexhe p.n. - Komuna Suharekë 23000

1. Pronari i gurthyesit dhe seperacionit

Fadil BYTYÇI – Drejtor

Suharekë Data: 17.08.2026

SHTOJCA 1

FORMULARI I KËRKESËS PËR LEJE MJEDISORE

Emri i kompanisë	FAMIS CO – HC SH.A.
Lloji i veprimtarisë	Gurthyes dhe seperim i gurit gëlqeror
Emri dhe mbiemri i aplikuesit / Nënshkrimi	FADIL BYTYÇI
Vendi dhe lokacioni	Lokacioni i gurores: Samadrexhë p.n. - Komuna Suharekë 23000
Telefoni , fax, e-mail	049772909
Kopja e Vendimit të Pëlqim Mjedisor	Po
Certifikatë përdorimi, ose Leje/ Licencë për ushtrim të veprimtarisë nga organi kompetent	Po
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro)	298,000.00
Fatura e pagesës se tarifës për Leje Mjedisore	Po
Aplikacionin original të plotësuar për Leje Mjedisore në 5 (pesë) kopje fizike dhe një elektronike (CD).	Po

SHTOJCA 2

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	FAMIS CO – HC SH.A.
	Vendi	Samadrexhë p.n. - Komuna Suharekë 23000
	Adresa	Njësia e kompanisë: Samadrexhë p.n. - Komuna Suharekë 23000
	Nr. i tel./fax	+38344485267
	E-mail	info@famis-co.com
1.1.2.	Numri unik i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810820680; regjistruar më: 17.10.2000, azhurnuar më: 13.12.2022
1.1.3.	Personi kontaktues për mjedis	Atdhe Gallopeni
	Nr. i tel./fax	049772909
	E-mail	info@famis-co.com

1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Samadrexhë, Suharekë
1.2.3.	Informatat për mjedisin- ndikimet nga kryerja e aktiviteteve	Nga aktivitetet e Kompanisë: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, ndikimet kryesore në Mjedis janë: ndikimet në ajër, ujë, tokë dhe ndikimet nga zhurma. Këto ndikime janë të paraqitura në pikat 5.1.1, 6.1.1, 7.1.1 dhe 8.1. të Aplikacionit për dhënien e Lejes Mjedisore

2. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË		
2.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore		
2.1.1.	Skema e procesit teknologjik	Skema Teknologjike në shtojcën 1 të Aplikacionit

2.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Përshkrimi i procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror Për realizmin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror janë të vendosura këto pajime: Thërrmuesi primar statik me kapacitet teorik 100m^3 në orë, me kapacitet të realizuar 80m^3 në orë, thërrmuesi sekondar. Para thërrmuesi primar statik është i vendosur bunkeri pranues me vëllim 20m^3 i cili thërrmohet në dozatorin me vibrim, pasandaj transportuesi shiritor për bartje të materialit nga gurthyesi me kapacitet $80\text{m}^3/\text{orë}$. Pastaj ekzistojnë transportues shiritor përmes të cilave materiali i seperuar transportohet me njërin shirit transportues në deponinë adekuate për deponimin e fraksionit të gurit gëlqerorë kurse fraksioni $+4\text{mm}$ i mbetur pa u thërrmuar në madhësinë 4mm transportohet me njërin shirit transportues në gurthyesin ose thërrmuesin me traj për tu ri-thërrmuar.
--------	--	--



Thërmuesja primare

		Procesi teknologjik i gurthyesit me seperacion Prodhimi në gurthyes me seperacion bëhet në bazë të kërkesave të blerësve, në bazë të cilave bëhet edhe plani i biznesit të Kompanisë. Prodhimi në gurthyes me seperacion bazohet në prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, për agregat betoni dhe agregat asfalti. Ne vijim po japim përshkrimin e procesit teknologjik të gurthyesit me seperacion. Guri gëlqeror gjegjësisht guri gëlqeror me fraksione 32 mm transportohet me kamionë të veçantë për transportimin e masës shkëmbore. Gabaritet e masës shkëmbore të cilët ngarkohen në kamion nuk guxojnë të jenë më të mëdhenj se 900 x 600 mm. Gëlqerori nga kamionët derdhen në bunkerin pranues të cilin në kemi dhen në vizatim shtesë të Raportit, me kapacitet prej 20m³ e shënuar me (poz.1), mandej me anë të dhënësit vibrues kalon në shiritin transportues të pjerrët (poz.2), i cili e transporton fraksionin e gurit gëlqeror në thërmuesen me traj poz 3. Nga thërmuesja primare statike poz 3 guri gëlqeror nëpërmjet transportuesit shiritor (poz.2), e cila e transporton fraksionin e gurit gëlqeror në thërmuesen me traj poz 3 nga thërmuesja me primare statike poz. 3 guri gëlqeror me transportues shiritor poz. 4 transportohet në siten vibruese nr. 5. me dimensione 600- 220 mm, një etazhore me një site me vrima 4.5 mm nga ku fraksioni 0- 4 mm përmes transportuesit shiritor poz 6 dërgohet në deponinë adekuate pozita 7 për deponimin e fraksionit të gurit gëlqeror kurse fraksioni + 4 mm përmes transportues shiritor poz 4 kthehet në thërmuesja me primare statike nr. 3. Për tu thërrmuar prapë. Një pjesë e fraksioneve me madhësinë më të madhe se sa vrimat sitës përsëri përmes transportues shiritor poz 4 kthehen në thërmuesja me primare statike poz 3 ku do të thërrmohet në madhësinë e fraksioneve të lejuara dhe kështu e përgatitur së bashku
--	--	---

		me materialin tjetër me transporter shiritor poz.4 kthehet ne siten vibruese poz 5 për trajtim te dytë nëse ka nevojë ajo ne mënyre kontinuale do të kthehet edhe herave tjera ne thërrmuesja me primare statike gjer sa te fitohet madhësia e fraksioneve që do të kalojnë në rrjetën e sitës. Menaxhimi i procesit teknologjik bëhet nga dhoma e cila është e ndërtuar afër gurthyesit e në të cilën janë të vendosur ormani me tërë automatiken dhe mbrojtësit për tërë hargjuesit e energjisë elektrike, si dhe pulti komandues i cili është i vendosur në ormanin adekuat të caktuar për te. Automatika është e rregulluar në atë mënyrë që mundëson lëshimin në punë të pajimeve të seperacionit në mënyrë automatike dhe manuale. Në pultin komandues ekziston rregullatori komandues për zgjedhjen e punës së gurthyesit me seperacion. Nëse zgjedhim punën automatike, atëherë për fillimin e startimit të pajimeve të seperacionit, pajimet lëshohen në punë automatikisht, duke filluar nga më të largëtat kah të afërmet, nga transportierët për fraksionet finale, pasandaj sitat vibruese, transportierët shiritor tjerë, gurthyesen me traj , transportierët shiritor, sitën vibruese, transportierët shiritor, thërrmuesen nofulllore dhe në fund dozuesin vibrues. Te ndalesa e pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike, pajimet ndalen me radhë në anën e kundërt të lëshimit të pajimeve duke filluar nga dozuesi vibrues e tutje. Të zgjedhja e punës në mënyrë manuale, pajimet lëshohen në punë secila në vete, përmes tastereve të veçanta, sipas zgjedhjes ton, gjithashtu edhe te komanda manuele duhet respektuar radhën, e lëshimit të pajimeve në punë, sikurse të mënyra automatike. Udhëheqja manuele preferohet vetëm në raste të defekteve, dhe në raste të remontit të pajimeve. Në këtë mënyrë, me anë të këtyre proceseve teknologjike në gurëthyesin me seperacion mund të prodhohjmë këto fraksione nga guri gëlqeror: fraksione për tampon të rrugëve, fraksione për beton të cilat do të i paraqesim më poshtë.
--	--	--

		Fraksionet e tamponit të të rrugëve 0 - 31.5 mm 0 - 63 mm 0 - 100mm Fraksione e Betonit 0 - 4 mm 4 - 8 mm 8 - 16 mm 16 - 31.5 mm Përveç pajimeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror dhe shërbimeve tjera kompania disponon mekanizëm ngarkues dhe transportues si p.sh. lopata ngarkuese, ekskavator, kamionë për bartjen e gurit gëlqeror gjer te gurthyesi, si dhe trafon dhe gjeneratorin për furnizim me energji elektrike. Komponentët hyrëse në procesin e thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqerorë në Kompaninë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror janë: • Gurit gëlqeror • Energjia elektrike. • Uji Karburantet si lëndë djegëse nafta shërben për furnizimin e automjeteve transportuese dhe ngarkuese. Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike,
--	--	---


		nëpër mes trafostacionit që është pronë e kompanisë. Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare, për spërkatjen e sipërfaqes operacionale (gurthyes me seperacion), ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara. Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve p.sh për një punëtor nevojiten 25 lit. ujë/ditë. Furnizimi me ujë bëhet nga pusi i cili është nxjerr me shpim të thellë nga pronari i Kompanisë. Komponentët dalëse në procesin e aktiviteteve në procesin teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror janë : • Avujt i hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga makinat transportuese. • Zhurma. • Mbeturinat e ngurta. • Karburantet djegëse të lëngëta nafta • Ujërat e ndotura.
2.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 ore x 6 dit 48 ore në javë orari punës prej orës 8 deri 16.
2.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar	Kapaciteti i planifikuar prodhues i masave të minuara është $Q=50.000\text{m}^3/\text{vit}$, Kapaciteti i gurthyeses $Q=80\text{ m}^3/\text{h}$
2.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse, energjisë, uji, etj.	Agregati

		• fraksionet +0-4mm ; +4-8mm ; +8-16mm • Çimentoja • Uji • Aditivët
2.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Kompania FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk ka rezervuar për deponimin e naftës
2.1.7.	Lista e legjislacionit dhe udhëzimeve administrative në fuqi	Lista e rregulloreve Për plotësimin e formularit për Leje Mjedisore për kompaninë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror janë shfrytëzuar: • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 Ligji për VNM Nr. 03/L-214 • Ligji për VNM-në Nr.08/L-181 • Ligji për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163 • Ligji nr.04/L-158 për ndryshimin e Ligjit nr.03/L-163, për minierat dhe mineralet Ligji për ndërtim nr. 04/L-110 • Ligji për Planifikim Hapësinor nr.04/L-74 Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-33 Ligji për Mbeturina nr.04/L-060 • Ligji për Kimikate nr.04/L-197 • Ligji për mbrojtjen e ujërave Nr. 04/L-147 • Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160 Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012 • Ligji për Inspektime nr.08/L-067 • Ligji i Inspektoratit të MMPH nr.04/L-175

		Udhëzimet administrative • Udhëzim Administrativ Nr.04/2022 për Leje Mjedisore • Udhëzimi administrativ-nr.05/2013 Për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinat me Vajra • Udhëzimi administrativ- nr. 07/2015 Për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore • Udhëzimi administrativ-nr. 15/2012 Për menaxhimin e deponive të mbeturinave • Udhëzimi administrativ-nr. 27/2014 Për ambalazhin dhe ambalazhet mbeturinë • Udhëzimi administrativ- nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të mbeturinave • Udhëzimi administrativ.Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor • Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes. • Udhëzim administrativ-nr. 23/2012, Për menaxhimin e gomave jashtë përdorimit dhe mbeturinat e gomës
--	--	---

3. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

3.1.	Lokacioni	Lokacionit dhe Mjedisit Lokacioni i kompanisë: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror është vendosur në ngastrën kadastrale në Zonën Kadastrale: Samadrexhë; Njësia: P-72116038-00294-2, Komuna Suharekë, ku kompania FAMIS CO – HC SH.A. ka marrëveshje shfrytëzimi me të cilën dëshmohet me kontratë noteriale me Nr. LRP 5586/2023, Nr.i Ref. 288/2013. Lokacion ku gjendet kompania: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror ndodhet jashtë zonës se vendbanimeve. Në bazë të gjitha analizave është sajuar mundësia për vlerësimin global të gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme negative gjatë aktivitetit të thërrmimit dhe seperim të gurit gëlqeror. Në afërsi të kompleksit nuk gjenden objekte të banimit, objektet e banimit më të afërta gjenden në largësi mbi 200m. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me veprimtaritë, që mund të ketë ndikime të theksuara në mjedis.
3.1.1.	Numri kadastral i parcelës	Lokacioni i kompanisë: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror është vendosur në ngastrën kadastrale në Zonën Kadastrale: Samadrexhë; Njësia: P-72116038-00294-2, Komuna Suharekë, ku kompania FAMIS CO – HC SH.A. ka marrëveshje shfrytëzimi me të cilën dëshmohet me kontratë noteriale me Nr. LRP 5586/2023, Nr.i Ref. 288/2013
3.1.2.	Përshkrimi i zonës dhe lokacionit të impiantit sipas hartës së bashkangjitur	Ne afërsi të kompleksit nuk gjenden objekte të banimit, objektet e banimit më të afërta gjenden në largësi mbi 800m Ne vijim po e paraqesim pjesën e hartës topografike ku shihet lokacioni i kompanisë: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë



Pozicioni i vendburimit FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë

		Ortofoto e vendburimit FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë – Suharekë
3.1.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objekteve dhe aktiviteteve të tyre në kuadër të zonës sipas hartës së bashkangjitur	FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror është vendosur në ngastrën kadastrale në Zonën Kadastrale: Samadrexhë; Njësia: P-72116038-00294-2, Komuna Suharekë, ku kompania FAMIS CO – HC SH.A. ka marrëveshje shfrytëzimi me të cilën dëshmohet me kontratë noteriale me Nr. LRP 5586/2023, Nr.i Ref. 288/2013. Në afërsi te kompleksit nuk gjenden objekte te banimit, objektet e banimit me te afërta gjenden ne largësi mbi 800m.
3.1.4.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të	FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror

	mbrojtjes	është vendosur në ngastrën kadastrale në Zonën Kadastrale: Samadrexhë; Njësia: P-72116038-00294-2, Komuna Suharekë, ku kompania FAMIS CO – HC SH.A. ka marrëveshje shfrytëzimi me të cilën dëshmohet me kontratë noteriale me Nr. LRP 5586/2023, Nr.i Ref. 288/2013, objektet e banimit më të afërta gjenden në largësi mbi 800m. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit. Duke pasur parasysh llojin e projektit, madhësinë e objektit dhe pozitën e lokacionit ku gjendet lokacioni i kompanisë: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror është vendosur në ngastrën kadastrale në Zonën Kadastrale: Samadrexhë; Njësia: P-72116038-00294-2, Komuna Suharekë, ku kompania FAMIS CO – HC SH.A. ka marrëveshje shfrytëzimi me të cilën dëshmohet me kontratë noteriale me Nr. LRP 5586/2023, Nr.i Ref. 288/2013, nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, sepse ky lokacion nuk është në zonë të ndërtuar me objekte banimi, prandaj syri i njeriut është mësuar me këtë gjendje të mjedisit. Lokacioni i kompanisë: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk është në zonë të veçantë të Mbrojtjes.
--	-----------	---

4. MENAXHIMI I MBROJTJES SË MJEDISIT

4.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim: - Respektimin e legjislacionit vendor - Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit - Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit - Përmirësimin e komunikimit me autoritetet
4.1.1.	Raportimi	

5. AJRI

5.1.

Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse

Gjatë funksionimit kontinual të FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë , thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror ndotja e ajrit vjen nga qarkullimet e automjeteve transportuese te gurit gëlqerorë. Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO₂ dhe Pb.

Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin e kompleksit për Pluhurat te cilat lirohen gjatë seperimit te fraksioneve në sitat vibruese. Pluhurat të cilat lirohen nga deponitë të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të materialit të thërrmuar. Pluhurat të cilat lirohen gjatë ngarkimit dhe transportimit të fraksioneve ne automjetet transportuese. Pluhurat të cilat lirohen nga rrugët jot ë asfaltuara dhe sipërfaqeve operationale që ndodhen në afërsi të gurthyesit me seperacion.

Thërrmimi dhe Seperimi e gurit gëlqeror.

Ndotje e mjedisit ndodh nga pluhuri i cili lirohet dhe emitohet gjatë punëve dhe aktiviteteve në minierë sidomos gjatë procesit të ngarkimit dhe shkarkimit, te gurit gëlqerorë, gjatë procesit të transportit, pluhuri i cili lirohet në momentin e thyerjes së masës d.m.th. Te thërrmuesja primare statike, sekondare, pluhurat te cilat lirohen gjatë transportit të fraksioneve në të gjitha shiritat

		transportues. Duke i marruar parasysh përqendrimet e ndotësve të cilat emitohen në lokacionin e kompleksit për Thërrmimin dhe Seperimin e gurit gëlqeror, mund të përfundohet se ndotja e ajrit është me përmasa relativisht nën përqendrimet e lejuara dhe janë lehtë të kontrollohen.
5.1.1.	Ndikimet në Ajër	Ndikimet në ajër Gjatë realizimit të procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, ndikime negative në ajër ndodhin nga: Pluhuri i cili lirohet çdo herë në momentin e thyerjes së masës, do të thotë të thërrmuesja primare statike, thërrmuesja sekondare Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit. Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve në të gjithë shiritat transportues. Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues i fraksioneve në automjetet transportuese. Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operacionale që ndodhën në afërsi të gurëthyesit me seperacion. Pluhurat të cilët lirohen gjatë seperimit të fraksioneve në sitat vibruese. Pluhurat të cilët lirohen nga deponitë të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të materialit. Ndotja e ajrit ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet

		transportuese, që nevojiten për transportimin e fraksioneve të agregatit
5.1.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Ndikimi i emisionit të materieve ndotëse në kualitetin e ajrit varet para se gjithash nga kushtet klimatike –meteorologjike dhe numri i automjetet transportuese që transportojnë fraksioneve të materialit. Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë funksionimit të kompleksit të mihjes dhe gurthyesit duhet merren këto masa: E gjithë hapësira e kompleksit të mihjes dhe gurthyesit duhet të spërkatet me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta. Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajimeve për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror e posaçërisht stabilimenteve të cilat të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit. Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e sistemit të instaluar për zvogëlimin e pluhurit me ujë dhe pastaj me filtër. Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues të dëmtuarit të ndërrohen Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i makinave që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
5.1.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjetet brenda dhe jashtë kompleksit të mihjes dhe gurthyesit. Pluhurat të cilët lirohen nga deponitë të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të agregatit, pluhurat të cilët lirohen nga shiritat transportues gjatë transportit të fraksioneve të agregatit, lirimit të pluhurit nga sipërfaqet manipuluese.

5.1.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Masat e marra për mbrojtjen e ajrit Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve të mihjes dhe gurthyesit duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese (pirunëve) dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ. Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si produkt i djegies së lëndëve djegëse është e nevojshme të sigurohen kushtet për djegie sa më kualitative.
5.1.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	Për ta parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative ne ajër te cilat i kemi cekur më lartë, rrugët ku bëhet transportimi i masës shkëmbore duhet vazhdimisht të spërkatet me ujë. Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit duhet te mënjanohe apo zvogëlohet gjer ne kufijtë e lejuar, që nuk do te këtë ndikime te mëdha për mjedisin. Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë se pluhurit kompania është e detyruar të bëjë instalimin e sistemit te ujit për zvogëlimin e sasisë se pluhurit. Furnizimi me ujë do të bëhet nga pusi (bunari) pronë e kompanisë, ose furnizimi i ujit ti nevojshëm me cisternë, me anë të pompës së ujit nëpër mjet gyp sjellësve sillet gjer te gurthyesi me seperacion. Sistemi i ujit për zvogëlimin e pluhurit i cili lirohet gjatë procesit të thërrmimit dhe seperimit duhet te vendoset në tërë stabilimentet të cilat lirojnë pluhur dhe atë në bunkerin pranues, në gurthyes primare me nofulla, gurthyesen sekondare dhe terciare, ne te gjitha sitat vibruese, dhe ne te gjithë shiritat transportues. Ne sistemin për zvogëlimin e pluhurit duhet vendosur valvule për lëshimin dhe

		rregullimin e sasisë së ujit në mënyre mekanike, gjithashtu duhet të vendosen diznet të cilat e lëshojnë ujin në forme mjegulle e cila bën ujitjen e sipërfaqeve - hapësirave, dhe në këtë mënyre masa e cila do të thërrmohet dhe seperohet, si dhe fraksionet e ujit ashtu që nga masa dhe fraksionet nuk mund të lirohet pluhuri. Uji i cili shërben për mënjanimin e pluhurit duhet të rregullohet në sasi vetëm sa të beje rrëzimin e grimcave të pluhurit që të mos shpërndahen në mjedis, kjo sasi varet nga lagështia e gurit gëlqeror i cili thërrmohet dhe seperohet. Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit nëse në instalimet e sistemit të ujit nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjer në kufijtë e lejuar, që nuk do të këtë ndikime të mëdha për mjedisin, duhet të shiritat transportues e posaçërisht shiritat transportues që transportojnë fraksione të imta duhet të mbulohen dhe në vend-rrjedhje të fraksioneve duhet të ndërtohen hinkat. Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit nëse me instalimin e sistemit të ujit dhe masat e lartcekura nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjer në kufijtë e lejuar që nuk do të këtë ndikime të mëdha për mjedisin, kompania duhet të bëjë instalimin e sistemit të depluhurimit me anë të filtereve që është sistem i avancuar për zvogëlimin e pluhurit. Ne vijim do të bëjmë përshkrimin e procesit teknologjik të deplurimit. Pluhuri i cili krijohet gjatë procesit teknologjik thithet nga stabilimentet me ndihmën e ajrit përmes gypave që do të montohen në vendet ku krijohet pluhuri. Sasia e ajrit të thithur do të caktohet në bazë të përvojës dhe matjeve të bëra në pajimet e zhvendosura për pluhurosje. Në çdo vend për pluhurosje do të ekzistojë flutura rregulluese mbi të cilën rregullohet sasia e ajrit të thithur. Te gjithë gypat do të jenë ashtu të dimensionuar sa që shpejtësia e ajrit në ta është mjaft e madhe sa që nuk do të këtë fundërrim, ngjitje, palosje të pluhurit në gypa. Te gjithë gypat thithës do të jenë të lidhur me gypin kryesor mbledhës të pluhurit i cili është
--	--	---

		i kyçur në filtrin. Ne vendet lidhëse te gypave vendosen mbyllëset e gomës te cilat shërbejnë si mbyllës njëherit edhe si izolator te ajrit. Ne filtrin e thate prej bezi nga ajri i ndotur ndahet e tere sasia e pluhurit d.m.th. bëhet filtrimi i ajrit përmes bezit filtrues. Efekti i kësaj ndarje është mbi 99%. Koncentrimi i pluhurit ne dalje nga filtri sillet nen 50 miligram për metër kub. Filtri i bezit është i pajisur edhe me stabilimente për pastrimin e thasëve, përndryshe shtresat e pluhurit do te pengojnë krejtësisht filtrimin dhe punën e te gjitha pajimeve ose stabilimenteve. Pastrimi bëhet me ventilatorin për fryrjeje i cili me ndihmën e një mekanizmi largohet prej thesi ne thes dhe bën fryrjen e thasëve me lëvizjen e ajrit nen shtypje. Lëvizja e ventilatorit për fryrje prej thesit ne thes dhe koha e pauzës ne mes thasëve caktohet me ndihmën e releut kohor ne programatiken e filtrit. Ajri i pastruar nga filtri kalon përmes gypave ne ventilatorin kryesor dhe prej aty ne oxhak dhe del nga sistemi për pluhurosje. Pluhuri i ndare ne filtër largohet me kërmill dhe hyn ne dozatorin e transporterit pneumatik prej aty me ndihmën e ajrit te komprimuar transportohet ne silos. Silosi është i pajisur me nivelues i cili regjistron nivelin maksimal ne silos. Zbrazja e silosit behet me ndihmën e stabilimenteve për mbushje me do rose mekanike i cili kyçet ne autocisternë. Për rrëzimin e pluhurit te shtresuar ne pjesën konike te silosit behet me ajër te komprimuar. Kërmilli i pjerrët transportues i cili transporton pluhurin nga pjesa e poshtme te filtrit ku grumbullohet pluhuri ka një hapje plotësuese e cila shërben për pastrimin e tij. Pajimet për shpluhursje duhet të përbëhen nga këto elemente • filtri me bez te thatë. • ventilator centrifugal • gypat, lakesat , reduktor, flutura rregulluese , ndarës dhe oxhaku
--	--	--

		• transporteri pneumatik • silosi Pajimet dhe vendi ku duhet te behet largimi i pluhurit janë këto: 1. Thërrmuesja primare statike 2. Thërrmuesja sekondare 3. Ne hinkat për derdhjen e materialit 4. Ne sitat vibruese 5. Ne shiritat transportues Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, përpos masave te lart cekura duhet ndërmarr edhe këto masa: - Duhet te behet mirëmbajtja e rregullt e pajimeve për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror e posaçërisht stabilimenteve te cilat te cilat janë burim i emisioneve te pluhurit. - Duhet te behet mirëmbajtja e rregullt e sistemit te instaluar për zvogëlimin e pluhurit me ujë dhe pastaj me filtër. - Duhet te behet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues te dëmtuarit te ndërrohen. - Duhet te behet kontrollimi i rregullt i automjeteve te renda dhe konsumuesve tjerë te lendeve te lëngëta djegëse me qellim të zvogëlimit te emisioneve në ajër. - Gjatë transportit të materialit (shkëmbit gëlqeror) nga fusha eksploatuese deri te gurthyysi rimorkioja duhet të mbulohet me çadër apo foli najloni.
--	--	---

5.1.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk bën monitorimi i emisioneve
5.1.7.	Kontrolli dhe matjet	Kompania: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk bën kontroll dhe matjet
5.1.8.	Raportimet	
5.1.9.	Treguesi i emisioneve kryesore përqendrimet dhe sasia vjetore	Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO _x , HxCy, SO ₂
6. UJI		

6.1.	Ujërat e ndotura	Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore është nëse vjen nga të reshurat atmosferike të cilat gjatë rrjedhjes së tyre në zonat e shfrytëzimit, në punishte mund të jenë të ndikuara nga materiale të ndotura dhe të njëjtat të ngritin papastërtinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Në punishte të shfrytëzimit duhet orientuar që mos të jenë të akumuluar në pjesët e shfrytëzimit por nga kanali i hapur përgjatë fushës së shfrytëzimit të orientohen në pusët sedimentuese.
6.1.1.	Ndikimet në ujë	Derdhja eventuale e derivateve si nafta, vajrat e ndryshme do të ndikojnë në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.
6.1.2.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor koncentrimet dhe sasia vjetore	Ne kompaninë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk gjeneron ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, pasi që ndërrimin e vajrave nuk e bënë brenda kompleksit por ne autoservis andaj edhe nuk ka emisione të ujërave të ndotura.
6.1.3.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Ne kompaninë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk gjeneron ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, por ndotja ndodhe si që e kemi përshkruar në pasuset e mësipërme në hapësirat punuese të mihjes prandaj janë të ndërtuar kanalet për grumbullimin për bartjen e ujërave nga të reshurat atmosferike nga tëra sipërfaqet, punuese të mihjes dhe gurthyesit. Ujërat e grumbulluar nga sipërfaqet e lart cekura nuk dërgohen për trajtim në separatorin për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të

		ngurta dhe me vajra e yndyra të ndryshme, sepse nuk kemi vajra pasi që mirëmbajtjen e pajisjeve dhe ndërrimi i vajrave operatori nuk e bënë brenda në miniere por jashtë Mijes. Kanalet duhet rregullisht të pastrohen.
6.1.4.	Në rast kur ujërat e ndotura shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësore	Në kompaninë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, uji nuk përdoret për proces teknologjik por uji shfrytëzohet për qëllime sanitare, për spërkatje të fushës eksploatuese, rrugëve dhe për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit, kështu që mundësia që ujërat e ndotura të shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësore është tejet i vogël.
6.1.5.	Në rast kur ujërat e ndotura nuk shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësore	Në kompaninë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, ujërat të cilët përdoren për qëllime sanitare, për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit, nuk shkarkohen drejtpërsëdrejti në recipient dhe me këtë minimizohet mundësia e depërtimit të tyre në ujërat nëntokësore.
6.1.6.	Të dhënat nga lejet për përdorim të ujit	Në kompaninë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë , thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk ka të dhënat nga lejet për përdorim të ujit
6.1.7.	Leje Ujore për shfrytëzim dhe shkarkimin e ujërave të ndotura	Kompania FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror ka aplikuar për Leje Ujore për shfrytëzim dhe shkarkimin e ujërave të ndotura
6.1.8.	Kontrolli dhe matjet	Nga funksionimi i Kompanisë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë , thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk gjenerohen ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të

		ujërave nëntokësore, ndërrimin e vajrave dhe riparimin e automjeteve nuk e benë në atë lokacion andaj edhe nuk ka emisione te ujërave te ndotura.
6.1.9.	Raportimi	
7. ZHURMA		

7.1.	Burimet	Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin e nervor, në hipertension, në koncentrimin e njeriut në punë etj. Lokacioni ku është i vendosur FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë , thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror, është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga faktorët e ndryshëm si: automjeteve transportuese, makinat punuese, makina shpuese, gjeneratori.
7.1.1.	Kontrolli dhe matjet	Gjatë fazës së ndërtimit vjen deri te ngritja e përkohshme e zhurmës nga funksionimi i automjeteve transportues dhe mekanizmave ndërtimor. Si pasojë e lëvizjes së automjeteve, autocisternave mundë të vie deri te ngritja e zhurmës e cila në lokacionet e punës gjatë orarit të punës (8-18) mundë të jetë prej 55 - 65 dB, në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 dhe Direktivën 2000/14UE për emisionin e zhurmës nga pajisjet e ndryshme që përdoren jashtë objekteve. Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.
7.1.2.	Raportimet	

8. TOKA

8.1.	Ndikimet në tokë	Gjate fazës së thërrmimit të gurit gëlqeror në vendburimin e kompanisë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë , ndikim negativ në tokë paraqitet në aspektin e degradimit të sipërfaqes së tokës , prishja e peizazhit, ndikim negativ në tokë paraqitet nga: - Depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga qarkullimi i makinave gjatë procesit të ngarkimit, dhe transportit të inerteve. - Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre, gjatë pëlcitjes të gypave hidraulik të mjeteve punuese. - Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga larja e automjeteve tjera transportuese. - Ndikimet negative nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmave, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. - Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet edhe nga deponimi i fraksioneve të aggregateve si dhe depozitimi i pluhurit nga këto fraksione. - Ndotja aksidentale e dheut e cila vije si pasojë e avarive të mëdha dhe të vogla.
8.1.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë duhet marrë këto masa mbrojtëse: - Është bërë betonimi i platos ku janë të vendosura pajimet operationale. - Tër sipërfaqet ku janë të vendosur gjeneratori, deponimi i vajrave

		dhe lubrifikanteve duhet të mbulohen me beton - Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në lokacionin e kompleksit grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara - Behet mirëmbajtja e stabilimenteve që nevojiten për realizimin e procesit për prodhimin, të gjitha pjesët lidhëse të gypave puthiten mirë me qëllim të pengimit të lirim të pluhurit. - Të gjitha mbeturinat e ngurta që nuk trajtohen më tutje si dhe mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponinë e qytetit. Vaji, derivatet dhe fluidet tjera që i posedojnë automjetet duhet të nxirren në hapësirën që duhet ndërtuar, që posedon kanalin i cili duhet të jetë i izoluar për mos depërtimin e tyre në tokë
8.1.2.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Këtij procesi nuk i është dhënë rëndësi gjatë shfrytëzimit të Minierave në kohën e kaluar por tani ku sipas dinamikës së punimeve kalohet nga deponimi i sterilizimit në sipërfaqe të tokave bujqësore në deponim të brendshëm (në hapësirat e shfrytëzuara), duhet që menjëherë të fillojë rikultivimin i sipërfaqeve të deponive të formuara. Deponitë e formuara në Vendburimin e gurit gëlqeror, nuk është bërë rikultivimi, prandaj propozojmë që shpati i shkallës së deponisë së sterilizimit të mbillen me bagrem, kurse sipërfaqet e rrafshëta të me pishë

		të bardhë gjegjësisht të zezë shih planin e rikultivimit në fazën përfundimtare. Zonat e përfshira nga aktivitetet e shfrytëzimit, duhet të rregullohen në atë mënyrë që shfrytëzimi i tyre i mëvonshëm do të jetë shumë më i mirë se më herët. Kjo përpjekje synon rritjen e vlerës së zonave krahasuar me gjendjen aktuale – së paku të ketë pamje të ngjashme. Zonat të cilat nuk nevojiten për aktivitete Shfrytëzimi duhet të rikultivohen sa më shpejtë që është e mundur. Nëse nuk do të jetë i mundshëm rinatyrizmi final, atëherë duhet të ndërmerren masat e duhura siç është për shembull gjelbërimi i përkohshëm. Autoritetet dhe palët e investuese (shfrytëzuesit e mëvonshëm) integrohen në procesin e planifikimit dhe dhënies finale të formës së zonave pas aktiviteteve Shfrytëzuese. Rikultivimi agroteknik Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga veprimtaria e shfrytëzimit të gurit gëlqeror për prodhimin e fraksioneve. Për të llogaritur numrin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend. $N_f = S / a \times b$ S - paraqet sipërfaqen, a – paraqet distancën në mes rendeve b – paraqet distancën në mes fidaneve Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distanca të jenë nga 4 m. Në pjesët ku do të behët mbjellja e bimëve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0.3- 0.5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik,
--	--	--

		pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar. Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që rrënjës t’i sigurojë shtrirje sa më të lirë. Nëpër këto gropa duhet të hedhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të shtallës e pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë. Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidaneve. Fidanet duhet të shoqërohen me ambullazh përkatëse ne momentin e blerjes. Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara. Para se të mbillen fidanet, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajge të freskët dhe argjili me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje. Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta. Gjatë dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasi të optimale të lagështisë, kështu ne pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj. Pas mbjelljes së silvokulturave, investitori më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre. Karakteri i dëmtimit të mjedisit natyror të shkaktuar nga punët minerare. Pas kryerjes së fazës teknike vazhdon faza e rikultivimit agroteknike e cila ka për qëllim adaptimin e tokës me vlerë profitabile dhe estetike. Zbatimi i masave agroteknike pasi që hapësirës ti është dhënë struktura përfundimtare do të behët në bazë të analizave të dheut i cili do të përdoret si substrat në gjendjen përfundimtare- është propozuar si shtresë përfundimtare të përdoret shtresa humusore e
--	--	---

cila do të hiqet më qëllim të shfrytëzimit të gurit gëlqeror. Shtrirja e shtresës humusore (me trashësi 0,5m) mbi toka të dëmtuara ka për qëllim që bimës ti ofrojë një substrat të përshtatshëm për rritje duke i siguruar materie ushqyese, reaksion të pranueshëm për bimën, lagështi optimale etj. Me kalimin e viteve bimët e rritura në këto hapësira me proceset e tyre fiziologjike do të ndikojnë që ky substrat ngadalë të ndryshojë dhe të kalojë në tokë pjellore. Shtresimi i materialit gjatë procesit të rikultivimit duhet të bëhet njëjtë me renditjen e materialit shkëmbor, si ka qenë para se të filloi shfrytëzimi i gurit gëlqeror.





Fig. Radhitja e shtresave të dheut gjatë mbushjes së hapësirës 1. Shtresa humusore, 2. Shtresa ujëlëshuese, 3. Materjali neutral dhe 4. Materjali jo pjellor

Rikultivimi i sipërfaqeve në formë terrace

Në kuadër të projektit Mbyllja – rikultivimi i MS në Vendburimin e gurit gëlqeror, është paraparë që forma përfundimtare e sipërfaqeve të gatshme për rikultivim do të jetë në formë të terracave. Terracat do të ndertohen pasi që pjerrtësia e shkallëve do të jetë me e madhe se 10°.

Terracat do të jenë të ndertuara nga pjesa e rrafshët – horizontale, ku do të mbjellët bima e pishës si dhe pjesa e pjerrët me bagrem, ku do të aplikohet rikultivimi me metodën e mbjelljes horizontale e drunjtëve në kombinim me aplikimin e metodës së hidrosemisë.



1. Shtresa humusore, 2. Material mesatarisht pjellor, 3. Material jo pjellor
Fig. Rikultivimi me ngritjen e terracave

Kemi zgjedhur tri variante të rikultivimit të cilat do të përshkruhen si metoda të aplikimit, ndërsa se cila formë e rikultivimit do të aplikohet do të jetë në kompetencë të investitorit. Mirëpo ekziston edhe mundësia e kombinimit të këtyre metodave në mes veti.

Variantet e rikultivimit janë:

- Rikultivimi me metodën e Hidrosemisë
- Rikultivimi me mbjelljen horizontale të drunjëve edhe
- Rikultivimi i plotë biologjik – vendosja e shtreses humusore

Hidrosemia

Hidrosemia apo hidrombjellja është një prej teknologjive me të reja të rikultivimit, është proces i shpejtë, i thjeshtë, efikas dhe ekonomik. Preferohet për të gjitha llojet e tokave mirëpo si metodë ka përparësi në ato toka me konfiguracion të papërshtatshëm për aplikimin e masave agroteknike. Zakonisht aplikohet për gjelbërim të tokave antropogjene, të deponive të hedhurinave urbane dhe industriale, pjesë të përfunduara të minierave, për rreth rrugëve si dhe në pjesët ku është prezent dukuria e erozionit. Aplikohet direkt në sipërfaqet me pjerrtësi shumë të mëdha pa ndërmarrjen e masave agroteknike.

Procesi i hidrosemisë fillon me përzierjen në mes të ujit, farës, plehrave inorganike dhe organike, humusit, ngjitësit dhe mulqit në një rezervar (makinë të hidrosemisë) i cili me anë të gypave me shtypje hedh materialin e përzier në sipërfaqen të cilën dëshirojmë ta mbjellim. Është propozuar si metodë për arsye se është e lehtë, e aplikueshme si dhe shumë shpejt shihen rezultatet e rikultivimit.

Sasia e materialit për parcellë (500m²) dhe ha

Fazat	Materiali	kg/500m ²	gr/m ²	kg/ha
Faza e I	Farë	25	50	500
	Humus	150	300	3000
	Kompost	100	200	2000
	Pleh artificial NPK	37.5	75	750
	Ngjitës	3.75	7.5	75
	Mulq	7.5	15	150
Faza e II	Mulq	7.5	15	150
	Ngjitës	3.75	7.5	75
Faza e III	Mulq	7.5	15	150
	Ngjitës	3.75	7.5	75

Rikultivimi me mbjelljen horizontale të drunjëve

Rikultivimi i pjerrtësive me anë të mbjelljes horizontale të bimëve është një metodë që tek ne ende nuk është aplikuar, sipas literaturës së konsultuar është metodë shumë efektive për eliminimin e dukurive të rrëshqitjes. Rikultivimi i pjerrtësive bëhet me anë të mbjelljes horizontale të bimës.

Teknologjia e mbjelljes është shumë e thjeshtë duke i njohur vetitë e vegjetimit të bimës e cila përdoret për këtë mënyrë të kultivimit. Arsyeja pse ne kemi propozuar këtë metodë të rikultivimit është se kjo formë e rikultivimit aplikohet në vendet me pjerrtësi ku mbjellja e materialit drunor bënë lidhjen e masave të dheut dhe pengon rrëshqitjen apo derdhjen e këtyre masave.

Rikultivimi i plotë biologjik –mbjellja e Bredhit (Picea omorica)


Qëllimi që në të ardhmen të kultivojmë bimë drunore në këtë zonë është se këto bimë nuk kanë kërkesa të mëdha për masat agroteknike. Bima e propozuar për rikultivimin e plotë biologjik është bima e bredhit Picea omorica.

Kushtet me të volitshme për kultivimin e kësaj bime drurore janë ato ku nuk paraqiten temperaturat e ulta dimërore dhe ngricat e vonshme pranverore. Duke ju falënderuar sistemit rrënjor mjaft të zhvilluar kjo bimë

		i përballon thatësisë duke u furnizuar me ujë nga toka. Në humusore prej 0,5m të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj bëhet ngjeshja e këtij substrati me qellim që ky substrat të jetë sa me kompakt. Pas këtij operacioni duhet të bëhet vrimimi në mënyrë të mekanizuar. Dimenzionet e gropës varen prej habituesit të sistemit rrënjor, pra thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është gjatësia e habituesit qendror të sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia të jetë e atillë që rrënja të ketë një shtrirje sa me të lirë d.m.th. gjatë vendosjes rrënjët të mos lakohen për mure të gropës. Në dheun e nxjerr prej gropës duhet të hudhen rreth 150gr /pleh mineral (NPK), i cili duhet të përzihet mirë me dhe. Një sasi e dheut vendoset në fund të gropës në formë koni mbi të cilin vendoset rrënja e bredhit, pastaj rrënja mbulohet me shtres të dheut prej rreth 5-10 cm. Këtë dhe duhet ngjeshur me këmbë, në mënyrë që dheu të ketë kontakt sa me të mirë me rrënjën dhe të mos ngeli ajër. Mbi këtë shtresë hudhen 10-20 kg pleh të djegur të shtallës. Plehu i shtallës nuk guxon kursesi të ketë kontakt me rrënjën. Shtresa e plehut të shtallës mbulohet me sasi të fundit të dheut. Të gjitha bimët kur të blihen nga prodhuesi duhet të shoqërohen me karantinë përkatëse (çertifikatë mbi gjendjen e tyre shendëtesore), të kontrollohen se në çfarë gjendje janë si dhe nga sistemi rrënjor të hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara mekanikisht. Para se të mbjellën bimët, rrënjët e tyre duhet të zhytën në solucion prej bajge të freskët dhe argjili, me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mire për rrënjën. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e bredhit është vjeshta, pasi që rrënja është aktive gjatë dimrit si dhe ekziston sasi optimale e lagështisë, kështu që bima në stinën e pranverës ka start me të suksesshëm. Përveq procesit të mbjelljes faktor tjetër që garanton një rikultivim të suksesshëm është përkujdesja për bimët në vitet pas mbjelljes - mirëmbajtja në vitet e ardhëshme që nënkupton: Plehrimin (sasia e plehut organik dhe inorganik përdoret mvarsisht nga rezultati I analizave laboratorike të substratit në gjendjen përfundimtare), ujitjen, krasitjen, mbrojtjen e bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm mekanik. • Shtresa humusore 0.5m
--	--	---

- Dheu i imët në formë koni i vendosur në fund të gropës
- Sistemi rrënjor i fidanit
- Shtresa e dheut të imët që mbulon rrënjën
- Shtresa e plehut të djegur të stallës dhe
- shtresa e fundit e dheut të imët

Distancat e mbjelljes së bredhit



Distancat e mbjelljes

Në skicë është paraqitur distanca e mbjelljeve që është 4 m rendi prej rendit, dhe 4 m bima prej bimës, drejtimi i mbjelljes është Lindje Perëndim

Materialet e nevojshme për tri variantat e rikultivimit

Materialet për realizim të hidrosemisë

Materialet për realizim të hidrosemisë lehtë përfitohen dhe kanë një kosto të ulët. Përfitohen

me riciklimin e mbeturinave bimore duke krijuar lloje të ndryshme të komposteve, mylqeve dhe ngjitësve ekologjike të përshtatshëm për rikultivim të tokave të degraduara. Materiali i përdorur për realizimi të hidrosemisë është: Ujë, pleh i lëngshëm, pleh organik dhe inorganik, ngjitës, mulq, komposto, humus i situr, humus granula dhe humus pluhur.

		Fara Fara e përdorur për hidrosemi është e ngjashme me atë të bimëve autoktone për arsye se këto bimë me lehtë i adaptohet kushteve klimatike. Janë preferuar llojet e ndryshme të barit me sistem rrënjor të zhvilluar. Fara duhet të jetë e certifikuar dhe me afat-mbirës optimal. Plehrat Plehrat me të përshtatshëm për kulturat bujqësore dhe të propozuar në projektin e rikultivimit të minierës, janë plehrat organike (plehu i stallës, komposti, fekalet dhe plehu i gjelbër) dhe plehrat minerale – NPK. Përparësi kanë plehrat e lëngshëm të cilët zakonisht përfitohen nga ujerat e plehut të stallave të cilët kryesisht janë të pasur me azot dhe fosfor, në sasia me të vogla përdoren plehrat artificiale. Humusi Sasia e humusit të përdorur të forma e rikultivimit me metodën e hidrosemisë të paraparë si formë të rikultivimit, duhet të jetë 2000 kg/ha. Procesi i shndërrimit të mbeturinave organike në humus, në vitet e para pas mbjelljes së bimëve do të jetë një proces i ndërlikuar biologjik, ku rolin kryesor dhe vendimtar do ta kenë mikroorganizmat. Kompostot Kompostimi është proces i zbërthimit mikrobiologjik i mbeturinave, kryesisht me prejardhje bimore, por edhe i mbeturinave organike me prejardhje shtazore. Komposti zëvendëson plehrat minerale dhe pesticidet, zvogëlon ndotjen nga përdorimi i tepërt i tyre si dhe zvogëlon shkallën e toksicitetit. Përdoret për plehërim themelor, ripleherim dhe mulqim. Ky lloj plehu organik paraqet përzierjen e mbeturinave të ndryshme organike siç janë: bari, kashta dhe mbeturinat e ndryshme. Mesatarisht ky lloj komposti përmban: 0,4% azot, 0,2% fosfor, 0,3% kalium dhe 3,8 % CaCO₃. Sasia e kompostit të përdorur të forma e rikultivimit me metodën e hidrosemisë të paraparë si formë të rikultivimit, duhet të jetë 600 kg/ha.
--	--	--

		Mulqi Mulqi ka për qëllim që bimës ti ofroj kushte me optimale për fazat e para të mbirjes, në kombinim me ngjitësin krijon biombulesën e cila benë që fara të jetë në kontakt me substratin dhe e ruan atë nga faktorët eroziv. Mulqi është një material me kosto të ulët dhe shumë ekologjik sepse krijohet nga riciklimi i mbeturinave të letrës apo mbeturinat e drurit nga punimi i mobilerive. Si mulq mund të përdoren fijet e holla të një përzierje në mes të kashtës dhe pambukut si dhe mbeturinat e letrës. Ngjitësi Ngjitësi i përdorur në procesin e hidrosemisë është një përzierje me prejardhje sintetike i aplikueshëm për vendet me pjerrtësi të mëdha. Mbron farën e bimës dhe materialin e hedhur në tokat e pjerrëta nga erozioni. Shumë i përshtatshëm për aplikim me metodë të hidrosemisë i cili në bashkëveprim me mulqin krijon shtresën mbrojtëse. Ngjitësi në kombinim me mulqin krijon shtresën ushqyese për bimën e cila ka për qëllim që bimës ti ofroj kushte me optimale për fazat e para të mbirjes, fara është në kontakt vazhdimisht me substratin, e mbron atë nga faktorët eroziv si dhe furnizon bimën e re me materie ushqyese. Materiali i nevojshëm për mbjelljen horizontale të drunjëve Materialet për realizim të mbjellëjes horizontale janë: • Trungu i shëlgut i ndarë në masë drunore nga 1m, • Shufrat dhe lidhëset e metalta. Materiali i nevojshëm për mbjelljen e bredhit Të forma e rikultivimit të plotë biologjik, materiali i nevojshëm është: • Bima e pishës, dhe bagremit, • Humusi si dhe • Plehrat organike & inorganike. Ruajtja - seleksionimi i shtresës humusore Toka është baza ku bimët marrin lëndë ushqyese për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Faktor themelorë i cili jep mundësinë për të krijuar prodhime
--	--	---

		bujqësore dhe zhvillimin e bimëve është humusi, si element kryesor që krijon përbërje ushqyese të nevojshme për zhvillim të jetës bimore. Humusi është mes në të cilën zhvillohen procese të ndryshme kimike fizike dhe biologjike, shumë herë të lidhura në mes veti. Këto kanë rol vendimtar në plleshmëri dhe ndikojnë në krijimin e humusit. Humusi krijohet me rritjen dhe tharjen reciproke të bimëtarisë së ndryshme, shtazëve, bazamenteve dhe proceseve tjera. Humusi i përmbush kërkesat e bimëve nëse ka vetitë fizike, kimike dhe mekanike të përshtatshme për zhvillim të botës bimore. Burim bazë për grumbullimin e humusit në tokë janë bimët e gjelbërta, të cilat për çdo vit depozitojnë në tokë dhe mbi sipërfaqen e saj sasi të mëdha të lëndës organike. Konservimi i palosjeve të jashtme Konservimi përkufizohet si mbrojtja dhe ruajtja e burimeve natyrore dhe të mjedisit. Ai është një proces dinamik dhe sigurohet nëpërmjet të ndërhyrjes aktive dhe menaxhimit më tepër se sa ruajtja pasive. Arsyet për konservim dhe principet që qëndrojnë pas strategjive të konservimit janë: • Ndryshimi i përdorimit të tokës mund të çojë në humbjen e diversitetit të habitateve dhe llojeve të veçanta. • Menaxhimi i konservimit kërkon ndërhyrje aktive për të ruajtur llojshmërinë nëpërmjet krijimit të një sërë habitatesh. • Interesi shkencor qëndron në shkallën e komuniteteve, llojet e bimëve dhe kafshëve të rralla. • Konservimi synon mbrojtjen e ekosistemeve ekzistuese për të ruajtur fondin gjenetik. Procesi i formimit të tokës është shumë i ngadaltë edhe pse toka është një burim i ripërtëritshëm. Sot përdoren mënyra të ndryshme për të kryer konservimin e tokës. Mbulesat bimore e cila shërben për konservim përbëhen nga bimë të mbjella për të mbuluar të gjithë sipërfaqen e tokës të një zone të caktuar. Bimët që përdoren për këtë qëllim kanë rrënjë fibroze që formojnë një shtresë të dendur, të lidhur në tokë. Kjo shtresë parandalon erozionin e tokës. Bimët më të zakonshme që
--	--	--

	përdoren për këtë qëllim janë: jonxha, tërfili, tërshëra dhe gruri. Mbjellja e këtyre bimëve parandalon zvogëlimin e lëndëve ushqyese të tokës, proces që njihet me termin harxhim i tokës. Bishtajoret si jonxha, trifili, etj qarkullohen me bimë të tjera për të zëvendësuar nitratat e harxhuara të tokës. Plehurat kimike përdoren për të zëvendësuar lëndët tokësore të rëndësishme që largohen nëpërmjet bimëve. Plehurat organike përdoren shkallë më të gjerë dhe më shpesh për zëvendësimin e lëndëve ushqimore të larguara nga toka. Rikultivimi biologjik Rikultivimi biologjik mundëson krijimin e bazamentit pjellor dhe të aftë që ti sigurojë bimës sasi optimale të lagështisë, ajrim dhe materie ushqyese. Detyrë themelore e rikultivimit biologjik në hapësirat e minierave është që sa më shpejt të bëjë kthimin e sipërfaqeve - tokave të vdekura në sipërfaqe shfrytëzuese. Me realizimin e rikultivimit biologjik në hapsirën eksploatuese të minierës, do të përfundojë procesi i rikultivimit dhe do të krijohet një ekosistem i ri në këtë mes. Në këto hapësira të dëmtuara pas rikultivimit do të krijohet barazpeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë toka, uji, ajri, flora, fauna dhe si peizazhi do të merr pamjen e një vendi rekreativ për punëtorët e minierës dhe komunitetin për rreth. Rikultivimi biologjik është punë shumë e rëndësishme në ripërtitjen e hapësirave të dëmtuara nga punimet xehëtare, sepse bimët gjatë evoluimit janë të adaptuara në kushtet e caktuara të ekosistemit, përshtatja e tyre në toka të degraduara është një proces i gjatë biologjik. Vetëm një numër i caktuar i llojeve të bimëve mund të mbijetojnë në ekosistemet për rreth mihjeve, pa marrë parasysh vetitë agrokimike dhe pedologjike të substratit. Përshtatshmëria e substrateve - tokës së dëmtuar për rikultivim biologjik, mund të caktohen vetëm me anë të analizave laboratorike dhe në bazë të analizave rekomandohen masat agroteknike. Rikultivimi biologjik i hapësirës së shfrytëzuar të gurit gëlqeror është paraparë të kryhet me tri forma të rikultivimit: • Rikultivim me metodën e hidrosemisë, • Rikultivim me mbjellje horizontale të drunjtëve në pozitat e
--	--

		pjerrëta, • Rikultivim të plotë biologjik-mbjellja e bimës së bredhit. Ekzistimi i biomasës në këto hapësira do të krijojë mikroklimë të volitshme duke zvogëluar temperaturën, duke rritur lagështinë e ajrit, duke e zvogëluar shpejtësinë e lëvizjes së erës si dhe intensitetin e zhurmës. Pjesët e gjelbëruara mund të realizojnë funksionin e vet vetëm nëse rregullohet sistemi i mbrojtjes i sipërfaqeve të gjelbëruara, prandaj gjatë ngritjes së habitateve bimore në toka të dëmtuara, duhet me marrë në konsiderim që këto pjesë të mos demtohen nga punimet e shfrytëzimit apo në ndonjë mënyrë tjetër. Këto toka të dëmtuara pas procesit të rikultivimit mund të shfrytëzohet për ngritjen qendrave rekreative, gjatë së cilës në këtë plan aktivizohet edhe projektimi i pjesëve arkitekturale të përcjellura me fitoprojekte Rikultivimi biologjik me metodën e hidrosemisë Sipërfaqet në të cilat do të kultivohen bashkësitë e bimëve të ndryshme në hapësirat e rikultivuara, do të shërbejnë si kullosa për fitimin e ushqimit të bagëtisë si dhe livadhe për vende rekreative. Livadhet dhe kullosat artificiale në krahasim me ato natyrore kanë përparësi të mëdha si: • Japin rendimente me të larta, • Krijojnë masë me te madhe vegjetative e cila është e nevojshme për terrenet rekreative, • Sistemin e bollshëm rrënjor lidhin tokën dhe mbrojnë atë nga erozioni. • Bari propozuar në këtë projekt është bari që adaptohet lehtë dhe në përzierje lufton për hapësirë. Hyn në grupin e barërave të ulëta dhe mesatarisht të larta. • Krijon mbulesë të mirë bimore dhe mbron token nga erozioni, • Rritet shpejtë dhe ripërtëritet mirë, • I përshtatet klima e lagësht dhe ka nevojë për ujë, i përshtatshëm për tokat alkalike.
--	--	--

		Lloji i barit të propozuar: ✓ Loietto Perenne “Ventoux” 15.0 % ✓ Dactylis Glomerata “Amba” 10.0 % ✓ Festuka Arundinacea “Fuego” 20.0 % ✓ Festuka Ovina “Ridu” 10.0 % ✓ Festuka Rubra “Echo” 10.0 % ✓ Festuka Pratense “Senu P.” 10.0 % ✓ Fleolo Pratense “Alma” 5.0 % ✓ Ginestrino “Leo” 5.0 % ✓ Bromus Inermis 5.0 % ✓ Trifoglio Ibrido “Aurora” 5.0 % ✓ Poa pratensis “Balin” 5.0 % Rikultivimi biologjik me mbjelljen horizontale të drunjëve Bima më e përshtateshme për këtë mënyrë të rikultivimit është Shelgu (lat.salix). Shelgu i bardhë (lat. Salix.) është bimë e familjes Salicaceae dhe rritet në lartësi deri në 25m mbi tokë. Rritet zakonisht në vendet me lagështi, krijon masë të bollshme drurore të nevojshëm për këtë formë të rikultivimit. Rikultivimi i plotë biologjik - Mbjellja e Bredhit (Picea omorica) Bima e cila është zgjedhur për rikultivimi të plotë pas rehabilitimit të hapësirës së Vendburimit të gurit gëlqeror Gllama, është bredhi – Picea omorica, arsyeja pse zgjodhëm këtë bimë është se: ka vegetacion të bujshëm, është bimë gjethe mbajtëse, ka kurorë të gjelbërt edhe gjatë sezonës dimërore, atëherë kur të bimët gjetheramëse mungon vegetacioni, jep pamje të bukur peizazhit, freskon ambientin, me gjelbërimin e tij rregullon mikroklimen dhe nuk ka kërkesa të veçanta ndaj substratit.
--	--	---

9. MENAXHIMI I MBETURINAVE

9.1. Plani për menaxhimin e mbeturinave

Plani i menaxhimit me mbeturina do të mundëson:

- Reduktimin e prodhimit të mbeturinave nga aktiviteti i Kompanisë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror. Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060
- Menaxhimin me mbeturina të ngurta komunale duhet të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor. Plani i menaxhimit me mbeturina përfshinë aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Plani për menaxhimin e mbeturinave përmban, masat e zbatuara me qëllim të parandalimit të krijimit të mbeturinave, zvogëlimit të sasisë së tyre zbatimin e masave dhe teknikave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut, përcaktimin e mënyrës për magazinimin, trajtimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave. Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060.
- Menaxhimin me mbeturina komunale të cilat duhet të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

		- Menaxhimin me vajrat mbeturinë duhet të grumbullohen dhe të vendosen në fuqi të mbyllura dhe të siguruara mirë.
9.1.1.	Magazinimi i përkohshëm i mbeturinave	Gjatë aktivitetit të Kompanisë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk bën magazinimin e përkohshëm të mbeturinave por mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim
9.1.2.	Gjenerimi i mbeturinave sipas Katalogut Shtetëror të mbeturinave	Mbeturinat të cilat do të gjenerohen Gjatë aktivitetit të Kompanisë : FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror të ashtuquajtura mbeturinat komunale deponohen në kontejnerë dhe pastaj barten me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponitë regjionale për trajtim të mbeturinave. Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes të pajimeve të kompanisë deponohen në bure dhe ato dorëzohen tek ndërmarrjet e licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

		<table><tr><td>Mbeturina</td><td>Emri i mbeturinës</td><td>Shkalla e rrezikshmërisë</td><td>Lloji i deponimit</td></tr><tr><td></td><td>Letra</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner</td></tr><tr><td>13 01 13 02</td><td>Vajra dhe lubrifikante të përdorura</td><td>Te rrezikshme</td><td>bure</td></tr><tr><td>17 02 03</td><td>Plastika</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina</td></tr><tr><td>15 01 01 20 01 01 20 01 08</td><td>Mbeturinat e ngurta komunale</td><td>Jo te rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina</td></tr></table>	Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit		Letra	Jo të rrezikshme	Kontejner	13 01 13 02	Vajra dhe lubrifikante të përdorura	Te rrezikshme	bure	17 02 03	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina	15 01 01 20 01 01 20 01 08	Mbeturinat e ngurta komunale	Jo te rrezikshme	Kontejner për mbeturina
Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit																			
	Letra	Jo të rrezikshme	Kontejner																			
13 01 13 02	Vajra dhe lubrifikante të përdorura	Te rrezikshme	bure																			
17 02 03	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina																			
15 01 01 20 01 01 20 01 08	Mbeturinat e ngurta komunale	Jo te rrezikshme	Kontejner për mbeturina																			
9.1.3.	Pranimi dhe klasifikimi i mbeturinave sipas llojeve (në rast të përpunim dhe riciklimi)	Gjatë aktivitetit të Kompanisë: FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk behet pranimi dhe klasifikimi i mbeturinave sipas llojeve (në rast të përpunim dhe riciklimi)																				
9.1.4.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të Kompanisë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk behet përpunim dhe riciklimi e mbeturinave																				
9.1.5.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër- kontratë me kompaninë e Licencuar	Nuk dërgohen për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër																				
9.1.6.	Raportimi																					

10. RREZIKU NGA AKSIDENTET

Ne Kompaninë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk kemi deponim te karburanteve të lëngët. Aksidentet mund te ndodhin nga rrjedhjet e lendeve djegëse dhe lubrifikuese nga automjetet transportuese nga pëlçitja e gypave hidraulikë. Kompania nuk ka hartuar Planin për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Vlerësimi i rrezikut

Rreziku nga aksidenti vlerësohet në bazë të gjasave të ndodhjes së aksidentit dhe vëllimit të pasojave.

Vlerësimi i gjasave të ndodhjes së aksidentit

Gjasat e ndodhjes së aksidentit vlerësohen në bazë të dhënave mbi ngjarjet dhe aksidentet në pajisjet (stabilimentet) e njëjta ose të ngjashme në vendet tjera dhe të dhënave të përfituara nëpërmjet identifikimeve të rreziqeve.

Pasojat e mundshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin parashtrohen ne bazë të dhënave të përfituara me analizën e cënueshmërisë.

Me anë të analizës se cënueshmërisë evidentohen të gjitha entitetet dhe objektet e cënueshme ne rrethinën e burimit potencial të aksidentit:

- të punësuarit në kompleks
- pjesëmarrësit në trafik në rrugë
- objektet afariste dhe të banimit

Rekomandimet për evitimin e rrezikut

- Të bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrje e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve.
- Të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.
- Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si

dhe enët me rërë.

Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e kompanisë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë e posaçërisht nyjat sanitare, platoja me rrethin dhe gjelbërimi rrethues e tërë sipërfaqja e FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror është e rrethuar me tel gjembor dhe ku është nevoja edhe me mur statik.

10.1.

Plani për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm

Plani i brendshëm

Objektivat e Planit: Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale, ruajtja dhe mbrojtja e ambientit, vlerësimi i rrezikut, parandalimi i zjarreve

Qëllimi i planit:

Qëllimi i hartimit të këtij Plani është krijimi i prioriteteve për një koordinim sa më efikas në mes të subjekteve relevante të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e fatkeqësive – zjarreve. Zvogëlimit të rrezikut, gatishmëria për të mare vendime të duhura dhe koordinimi i veprimeve (ne raste të zjarreve përmasash të mëdha)

Plani i jashtëm

Qëllimet kryesore te këtij Plani janë : Të tërheq vëmendjen e përdoruesve dhe te autoriteteve përkatëse ndaj mundësisë se ndodhjes te një aksidenti dhe ndaj zbatimit te masave te nevojshme për shmangien e tij, të shmangë efektet serioze (si p.sh. vdekjet nga aksidentet), të zvogëloje shfaqjen e efekteve me aq sa mund te arrihet ne mënyrë te arsyeshme, të zvogëloje rrezikun e ndodhjes se aksidenteve ose te zbusë pasojat e aksidenteve kur ata ndodhin.

Për realizimin e objektivat te mësipërme, ky plan përmban këto

		çështje kryesore : Ekipet e emergjencave dhe përgjegjësit e tyre, trajnimi i punëtorëve, veprimet mbrojtës, mënyrat e veprimit, klasifikimi i territorit sipas kategorisë së kërcënimit nga aksidentet, përgjegjësitë.
10.1.1.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Kompania FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror nuk përdorë substanca të rrezikshme kimike dhe preparate
10.1.2.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Masat që duhet të merren në raste aksidenti - Të bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrje e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve. - Të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale. - Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë. - Të merren masat për evidentimin e derdhjeve të derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese. Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe fluideve si mbeturina specifike që mundë të ndodhin gjatë procesit, atëherë lëngu i derdhur duhet të pastrohet me absorbues kimik të cilat me lopata mblidhen dhe futen në fuqi ku mbahen në depo derisa të merren nga kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre. - Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e kompanisë. - Pronari është i detyruar të mbanë evidencën dhe ruan shënimet për dërgimin e tyre në qendrat e licencuara për riciklim, për sasinë dhe

		llojin e mbeturinave të seleksionuara, dhe sasinë dhe llojin e mbetjeve nga mbeturinat, me qëllim që të vërtetohet dalja e mbeturinave në këtë lokacion (vendi për grumbullimin e mbeturinave). Evidenca dhe shënimet duhet të mbahen sipas rekomandimeve që jepen në Ligjin për Mbeturin Nr. 02/L-30 dhe Udhëzimeve administrative për mbeturina të hartuara sipas rekomandimeve nga Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060. - E tërë sipërfaqja e fushës eksploatuese dhe seperacionit është e thurur me tel gjembor. Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e kompanisë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror e tërë sipërfaqja e kompleksit është e rrethuar me tel gjembor dhe ku është nevojë edhe me mur statik.
10.1.3.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Raporti i sigurisë duhet të përmbajë këto të dhëna dhe informata: Shënimet e lokacionit ku gjendet impianti, përfshirë pozitën gjeografike, kushtet meteorologjike, gjeologjike dhe hidro-grafike, por nëse është e nevojshme edhe të dhënat mbi terrenin; përcaktimi i stabilimenteve dhe aktiviteteve të tjera të impiantit të cilat mund të paraqesin rrezik nga aksidentet e mëdha; përshkrimi i zonave ku mund të vijë deri te efekti domino nga aksidenti i madh, përshkrimi i aktiviteteve kryesore dhe i prodhimit në pjesët e stabilimenteve të rëndësishme për sigurinë, burimit të rrezikut nga aksidentet e mëdha dhe rrethanave nën të cilat një aksident i tillë mund të ndodhë si dhe përshkrimi i masave preventive të planifikuara; përshkrimi i procedurave, në rend të parë mënyra e punës; Përshkrimi i substancave të rrezikshme, i cili përfshin: - vërtetimin e substancave të rrezikshme: emërtimi kimik,

		numri CAS (Chemical Abstract Simbol), emërtimi sipas nomenklaturës IUPAC, - sasinë më të madhe të substancave të rrezikshme që është apo mund të jetë e pranishme në lokacion; vetitë fizike, kimike dhe toksikologjike të substancave të rrezikshme dhe paralajmërimet e rrezikut për njeriun dhe Mjedisin; Vërtetimi dhe analiza e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mënyra e pengimit: Vlerësimi i pasojave të konstatuara nga aksidenti i madh. Përshkrimi i pajisjeve të shfrytëzuara gjatë sigurimit të stabilimenteve. Përshkrimi detal i rrjedhjes së mundshme të aksidenteve të mëdha dhe mundësisë së ndodhjes së tyre ose kushtet nën të cilat mund të ndodhin, duke përfshirë përshkrimin e situatës që mund të shkaktojnë në njërin nga zhvillimet e cekura të saj, pa marrë parasysh se a janë shkaktarët brenda stabilimentit ose jashtë tij; Masat mbrojtëse dhe masat për intervenim për kufizimin e pasojave të aksidentit: Përshkrimi i pajisjeve në stabilimente të shfrytëzuara për kufizimin e pasojave nga aksidentet e mëdha, organizimi i alarmimit dhe intervenimi, përshkrimi i mjeteve të jashtme dhe të brendshme që janë në dispozicion.
10.1.4.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	MASAT PRAKTIKE DHE TEKNIKE PËR SHUARJEN E ZJARRIT Shkaqet e ndezjes së zjarrit duhet të dihen dhe mënjahen, ose të pakësohen.

		Të gjitha pjesët e kompleksit të Gurthyese duhet të pastrohen duke i mënjeluar materialet e pa nevojshme, zjarret e hapura duhet të mënjahen, Vetëm punëtorëve të trajnuar duhet të ju lejohet të mëren me mirëmbajtjen, Punët që kanë të bëjnë me prerje dhe saldim duhet lejuar vetëm atëherë kur nuk ka zgjidhje tjetër. Të mëren masa sigurie kundër vëmjes së qëllimshme të zjarreve. Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe mjeteve tjera kimike. Planifikimi dhe përgatitja paraprake: Identifikimi i rrezikut, masat e reagimit në rast rreziku.
11. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT		
11.1.	Përshkrimi i ekspozimit të ndikimeve negative në mjedis.	Ndikimi në ajër Pluhuri i cili lirohet çdo herë në momentin e thyerjes së masës, do të thotë të thërrmuesja primare statike , thërrmuesja sekondare. Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit. Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve në të gjithë shiritat transportues.

		Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues i fraksioneve në automjetet transportuese. Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operacionale që ndodhën në afërsi të gurëthyesit me seperacion. Pluhurat të cilët lirohen gjatë seperimit të fraksioneve në sitat vibruese. Pluhurat të cilët lirohen nga deponitë të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të materialit. Ndotja e ajrit ndodhë nga gazrat të cilët lirohen nga automjetet transportuese, që nevojiten për transportimin e fraksioneve të agregatit. Ndikimet në ujë Derdhja e derivateve si nafta, vajrat e ndryshme Ndotja e ujit nga ujërat e zeza Ndotja nga ujërat e kuzhinës, tualetet etj. Ndikimet në tokë Ndotja e dheut si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqet e kompleksit dhe nga
--	--	--

		fundërrimit e komponentëve ndotëse nga ajri. Ndotja aksidentale e dheut e cila vije si pasoje e avarive të mëdha dhe të vogla.
11.2.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nuk ka ndërprerje momentale e punës së impiantit
11.3.	Ndërprerja e punës	Nuk ka ndalje të punës
Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut Gjatë funksionimit kontinual të kompanisë FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë - Suharekë, thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror , ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është minimal.		

SHTOJCA 1

SKEMA TEKNOLOGJIKE E GURTHYESIT ME SEPERACION FAMIS CO – HC SH.A. Samadrexhë – Suharekë

